

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E SHËRBIMEVE
QEVERITARE, ME OBJEKT "MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË,
LIGJISHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE" PËR
PERIUDHËN 01.01.2014-31.7.2015**

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, me objekt "Mbi zbatimimin e përputhshmërisë, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare" për periudhën 01.01.2014-31.07.2015, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 150, datë 11.11.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 657/7, datë 22.09.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar znj. Kamelia Vojka, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimimi i masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Referuar konstatimit nga auditimi mbi zbatimimin e buxhetit të shtetit ku nga dhënia me qira e ambienteve në administrim të DSHQ-së subjekteve të ndryshme, me kohëzgjatje 1 vit, subjekti "I." ka likuiduar vetëm vlerën prej 473,140 lekë në vitin 2015, ndërkohë që detyrimi kontraktor për vitin 2014, në total është në vlerën 1,104,333 lekë. Vlera prej 631,193 lekë është e palikujduar deri në momentin e auditimit duke u klasifikuar si detyrim i prapambetur.(Trajtuar hollësisht në fq.17 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Për këtë është rekomanduar:

Të merren masa nga DSHQ, për përmbushjen e detyrimit kontraktor në vlerën **631,193** lekë nga subjekti "I.", duke ndjekur hap pas hapi përmes përfaqësuesit ligjor të tyre, procedurat gjyqësore pranë Gjykatës Administrative, në cilësinë e të paditurit, meqenëse ky subjekt ka hapur proces gjyqësor ndaj DSHQ.

Menjëherë

2. Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, bazuar në dokumentacionin e audituar por edhe në materialet mbi te cilat hartohen pasqyrat financiare, si dhe në raportin e audituesit të pavarur i cili ka certifikuar pasqyrat financiare duke dhënë opinionin e kualifikuar në bazë të konstatimeve:

Aktivitet Afatgjata Materiale - DSHQ-ja ende rezulton të mos ketë çregjistruar disa aktive, të cilat ndërmjet procesit të privatizimit, kanë kaluar tek pronarët e ligjshëm (si për shembull, truall, ndërtesa, etj.).

Gjithashtu, vlera e aktiveve të trashëguara është pasqyruar me koston historike minus amortizimin e akumuluar në vite, ndonëse kjo vlerë, në të vërtetë është larg vlerës së tregut. Përveç sa më sipër, në magazinat e DSHQ-së ende ka aktive, të cilat janë plotësisht të amortizuara.

Zhvlerësimi i kërkesave të arkëtueshme - Në bilancin kontabël të DSHQ-së vijon të trashëgohet një provizion, i lidhur me kërkesat e arkëtueshme, në shumën prej 29,400,000 lekë, e cila është e trashëguar nga periudha e mëparshme, megjithëse baza metodologjike për llogaritjen e tij nuk është e qartë. Kjo shumë mund të përdoret për të mbuluar disa nga kërkesat e arkëtueshme afatgjata dhe pa shpresë arkëtimi, pasi të kryhen më parë të gjithë procedurat e duhura ligjore.

Në kushtet e mësipërme nuk mund të përlogaritet efekti i rregullimeve të nevojshme që mund të kryheshin në lidhje me saktësinë e shumës së zhvlerësimit të kërkesave të arkëtueshme për periudhën.

Pikërisht statusi i këtij zhvlerësimi është gjykuar si përgjegjësi e institucionit i cili duhet të gjejë një zgjidhje për këtë.

Në këtë kontekst grupi i auditimit u fokusua vetëm tek rregullariteti bilancit duke parë në veçanti ndërhyrje dhe probleme në inventarët e AQT-ve dhe masat e marra. *(Trajtuar hollësisht në fq.21-28 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

Për këtë është rekomanduar:

-Nga strukturat që përgjigjen për hartimin dhe raportimin financiar duhet të tregohet kujdes i veçantë për të saktësuar pozicionet të cilat rezultuan me probleme nga ky mision auditimi, si dhe të punohet me përkushtim për të kaluar në Raportime bazuar plotësisht në Standardet e Kontabilitetit të Sektorit Publik, duke nënkuptuar hartimin dhe miratimin e një Manuali Kontabël për Institucionin bazuar në veçoritë e trajtimit kontabël që ka në përputhje me praktikat më të mira kontabël ndërkombëtare.

DSHQ të ndjek hapat për të hequr nga llogaritë e saj kontabël aktivet afatgjata materiale që nuk janë më pronë e DSHQ por që nëpërmjet procesit të privatizimit sjanë më pronë e saj.

-Nga Drejtuesit e institucionit duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë ngritjes së kapaciteteve që merren me raportimin financiar, nëpërmjet trajnimeve dhe kërkesave për të njohur dhe implementuar standardet e kontabilitetit publik, duke vlerësuar rëndësinë që ka informacioni i saktë kontabël.

Menjëherë

3. Nga auditimi i veprimeve të kryera me arkën rezultojnë se janë kryer pagesa në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe më konkretisht:

a. janë kryer pagesa nga arka për dietat e punonjësve që dërgohen jashtë qendrës së punës me vlerë 2,500 lekë/ditë, pagesa këto që janë në kundërshtim me pikën 64 të udhëzimit të mësipërm ku thuhet "*Veprimet me para ne dore kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies **për udhëtime e dieta**, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 lekë"*

b. janë arkëtuar direkt në arkë të ardhurat e krijuara nga shitja nëpër banaqe dhe të ardhurat e krijuara nga dhënia e ambienteve me qira për parkim në kundërshtim me pikën 64 të udhëzimit të mësipërm, ku përcaktohet se "*Veprimet me para ne dore kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 lekë"* si dhe këto shuma janë shoqëruar me mandate arkëtime dhe fatura tatimore të cilat janë pa nënshkrimin e personit që ka paguar lekët. U konstatua raste të mandat arkëtimeve dhe mandat pagesave pa nënshkrimin e personit që ka derdhur lekët apo ka tërhequr në kundërshtim me pikën 68, ku përcaktohet "*Dokumentet e arkës shqyrtohen, kontrollohen dhe nënshkruhen nga personat e poshtëshënuar: a. mandatarëtkëtimi nënshkruhet nga personi përgjegjës për vlerat monetare, nga punonjësi që kryen derdhjen dhe nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij"*.

c. u konstatuan pagesat e pagave për 2 anëtarë të Këshillit Drejtues (13500 lekë secili), në kundërshtim me udhëzimin e më sipërm. Gjithashtu ato nuk janë shpenzim I zbritshëm sipas nenit 21/n të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Tatimin mbi të ardhurat". Gjithashtu mandat pagesat janë të firmosura nga vetë arkëtare e cila nënshkruan në vend të personit që përfiton lekët dhe i depoziton ato në llogarinë personale të anëtarit të Këshillit Drejtues.

d. gjithashtu u konstatuan pagesa nga arka me mandat pagesën nr. 66 datë 07.04.2014 “paradhënie page” për një punonjës, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi paradhënie e pagave nuk është e lejuar.

Me Mandat pagesën nr. 27 date 03.04.2015 paguar paga e muajit shkurt, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi pagesa të tilla nuk janë të lejuara. Gjithashtu ato nuk janë shpenzim i zbritshëm sipas nenit 21/n të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Tatimin mbi të ardhurat".(Trajtuar hollësisht në fq.21-31 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Për këtë është rekomanduar:

Drejtorja e Njësisë së Buxhetit, Raportimit Statistikor dhe Financës të marri masa që të nga arka mos të kryhen pagesa për pagat e anëtarëve të Këshillit Drejtues, paga personeli dhe të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i DSHQ me vlerë mbi 1000 lekë të kalojnë me bankë, duke minimizuar kryerjen e veprimeve me arkën.

Menjëherë dhe vazhdimisht

4. Për vitin 2014 dhe 2015 konstatohet se është hartuar regjistri i parashikimit të prokurimeve por rezulton se, diferencat janë të ndjeshme midis asaj që parashikohet dhe vlerave që realizohen.

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2014 janë realizuar në total blerje me vlera të vogla 14,951,792.94 lekë nga të cilat **12,934,328.94 lekë** janë prokurime të kryera me procedurën e ceremonialit zyrtar ose 86.6% e vlerës. Për 4 mujorin e parë të 2015 konstatohet se janë prokuruar me procedurën e ceremonialit vlera **5,029,472 lekë** nga vlera prej 6,100,015 lekë e prokurimeve për blerjet me vlera të vogla.

Nga auditimi i procedurave konstatohet se të gjitha furnizimet me mallra janë kryer me procedurën e ceremonialit duke mos i ndarë se cilat i shërbejnë ceremonialit zyrtar dhe cilat janë për të përballuar nevojat e përditshme në kundërshtim me përcaktimin e ceremonialit zyrtar në VKM nr. 229, datë 23.04.2004 “Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me kreu II, pika 1/b, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ndryshime, paragrafi i fundit ku “Për veprimtari të përcaktuar në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, vlera e përlllogaritur e prokurimeve me vlerë të vogël për artikuj apo grup artikujsh brenda një viti kalendarik të jetë nën vlerën e kufirit të ulët monetar” dhe pika 3 e VKM nr. 358, datë 24.4.2013 "Për mënyrën e prokurimit të mallrave, punëve e të shërbimeve, në kuadër të veprimtarive të ceremonialit zyrtar", ku përcaktohet se "Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare, në rastet e **organizimit të veprimtarive të veçanta**, sipas ceremonialit zyrtar dhe kur i kërkohet nga Drejtorja e Protokollit të Shtetit, përdor këtë procedurë prokurimi për blerjen e mallrave apo kryerjen e punëve ose shërbimeve." Duke i trajtuar si procedura ceremoniali i është shmangur rregullave të prokurimit publik në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. (Trajtuar hollësisht në fq.31-33 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Nga auditimi i praktikave për prokurimet e kryera me procedurën e ceremonialit, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

- në disa urdhra prokurimi është përcaktuar marka në kundërshtim me pikën 5, neni 23 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik”,
- të gjithë urdhrat e prokurimit nuk kishin të përcaktuar fondin limit në kundërshtim me pika 1/ç, kreu V të VKM nr. 1, më datë 10.01.2007 “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

ku thuhet “Kur sigurohen fondet, dhe ka nevojë për punë, mallra dhe shërbime, atëherë titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, i cili përmban të paktën sa vijon: objektin e prokurimit, **fondin e përlogaritur** të vënë në dispozicion, llojin e procedurës së prokurimit dhe justifikimin për përdorimin e saj”

-konstatohen mospërputhje midis datave të hyrjes së mallit dhe kryerjes së procedurës së prokurimit cka tregon për fiktivitet të kryerjes së procedurave. (Trajtuar hollësisht në fq.31-33 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Për këtë është rekomanduar:

-Nisur nga problematika e konstatuar, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare vetëm në plotësimin e nevojave të ceremonialit zyrtar në referim të përcaktimeve të bëra në VKM-në “Për ceremonialin zyrtar”, të prokurojë sipas përcaktimeve ligjore duke mos anashkaluar konkurrencën, ndërsa pjesa tjetër e nevojave ti nënshtrohet rregullave standarde të prokurimit publik, duke mos anashkaluar transparencën dhe përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.

-Drejtoria Juridike e DSHQ në hartimin e urdhrave të prokurimit të përcaktojë fondin limit për çdo procedurë prokurimi dhe në asnjë rast mos të përcaktojë markën e mallrave.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

5.Nga auditimi i prokurimeve publike konstatohet se në përgatitjen e dokumenteve standarde të tenderit me objekt “Blerje detergjente dhe mallra në ndihmë të kuzhinës dhe pastrimit**”, 4 maji I, viti 2015, dhe konkretisht në:**

-Formularin “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti teknik”, në lidhje me përvojën e mëparshme, nga AK nuk kërkohet dhe njëkohësisht nuk vendoset si kriter në dokumentet e tenderit të miratuar prej tij dhe të publikuar në faqen zyrtare të APP-së, paraqitja nga operatorët ekonomikë e “*dëshmisë për furnizimin e mallrave, i cili jepet nga marrësi i mallit ose/dhe faturave tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara*”, sipas kërkesave të Legjislacionit për Prokurimin Publik dhe konkretisht nenit 27/4, sek. II, Kreu III i VKM nr. 914 datë 29.12.2014.

-Gjithashtu në specifikimet teknike për blerjen e detergjenteve, kërkohen mallra “extra” të tilla si: shampo extra për kokë, shampo extra për trup, etj, duke cilësuar origjinën e mallit(prodhim italian, francez, gjerman ose britanik) pa shoqëruar me fjalët “ose ekuivalent” si kusht i kërkuar në nenin 23, pika 5 të Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006, me ndryshime dhe nenin 30, Sek. II, kreu III, të VKM nr. 914 datë 29.12.2014. Vendosja e kriterit “extra” bëhet pa asnjë specifikim teknik, që të bëjë të dallueshëm këtë mall për nga cilësia në krahasim me mallrat e tjerë të kërkuar. (Trajtuar hollësisht në fq.39-42 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Për këtë është rekomanduar:

Të merren masa nga DSHQ që në të ardhmen në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit dhe konkretisht, në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të vendosen kritere të qarta, në mënyrë që të jenë lehtësisht të kuptueshme nga operatorët ekonomikë vendosja e tyre për të bërë sa më transparent procedurën e prokurimit.

Menjëherë

6. Nga auditimi i praktikave bashkëlidhur pagesave u konstatua se të gjitha fletë hyrjet ishin të firmosura vetëm nga magazinieri dhe në disa raste ka korrigjime të numrit të fletëhyrjes në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” ku “Dokumentacioni quhet i rregullt

kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminonjë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve."

Gjithashtu u konstatuan se për produkte ushqimore konsumi të cilat nuk mund të qëndrojnë për një periudhë të gjatë dhe hyrje në magazine e DSHQ, bëhet deri në 19 ditë më vonë se fatura e blerjes së mallit, gjë që tregon për fiktivitet të fletë hyrjeve gjithashtu konstatohet se mallrat të jenë bërë hyrje dhe dalje me datë më vonë se zhvillimi i aktiviteteve për të cilin ato janë prokuruar. *(Trajtuar hollësisht në fq.33-35 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

Për këtë është rekomanduar:

Të marren masa nga DSHQ që fletë hyrjet të jenë të firmosura nga të gjithë personat, në mënyrë që të përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, të cilat përmbajnë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore dhe administrative.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

7. Nga auditimi i procesit të inventarizimit të pronave të DSHQ u konstatuan mangësi në kryerjen e plotë të inventarizimit gjatë një viti kalendarik si dhe në miratimin e raporteve të vlerësimit nga titullari, dhe më konkretisht si më poshtë:

- Nga auditimi i programit të punës për inventarizimin vihet re se gjatë një viti ushtrimor nuk është kryer i gjithë inventari në kundërshtim me pikën 74 të UMF nr. 30 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" ku thuhet: *"Çdo njësi publike duhet të kontrollojë te paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës."*

Si pasojë e mos kryerjes së inventarët të plotë dhe gjithë përfshirës për një kohë të gjatë kanë rezultuar diferenca dhe ka pasur problematika në identifikimin e mallrave. Nga auditimi rezulton se nuk ka pasur rakordime të rregullta midis përgjegjësit material të aktiveve me kontabilistin përgjegjës në financë. Gjithashtu ka diferenca në inventarin fizik duke u krahasuar me përshkrimet kontabël. Kjo konstatohet në inventarët të disa prej vilave ku pasur diferenca në inventar, ka mungesa dhe mallra tepër të cilët nuk figurojnë në inventarët e DSHQ. Për të zgjidhur këtë situatë është ngritur një komision, në përbërjen e të cilit ka ekspert vlerësues pasurie, të cilët kanë vlerësuar dhe kompensuar vlerat që mungonin pasi mallrat ishin të njëjtë në natyrë por kishin diferenca në përmasa të ndryshme. Ndërkohë që mallrat që nuk janë kompensuar i janë lënë për zhdëmtim personave përgjegjës.

- Nga auditimi i procedurave të kryerjes së inventarit konstatohet se janë ndjekur hapat sipas UMF nr. 30 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", vetëm procesverbalet e vlerësimit të aktiveve rezulton se nuk janë miratuar nga titullari në kundërshtim me pikën 105 të udhëzimit të mësipërm, ku thuhet *"Procesverbali hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Procesverbali miratohet nga titullari i njësisë publike"*. *(Trajtuar hollësisht në fq.33-35 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

Për këtë është rekomanduar:

Drejtori i DSHQ dhe Drejtoria e Njësisë së Buxhetit, Raportimit Statistikor dhe Financës të marrin masa që në hartimin e planeve të inventarizimit për çdo vit kalendarik të përfshijnë të gjithë aktivet e DSHQ dhe të saktësohen inventarët midis gjendjes kontabël dhe asaj fizike si në vlerë ashtu edhe në përshkrim duke evidentuar një herë e mirë diferenca dhe zhdëmtimin nga personat përgjegjës. Raportet e zhvlerësimit të nënshkruhen nga titullari sipas përshkrimeve të UMF nr. 30 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë dhe vazhdimisht

8. Nga auditimi i prokurimeve dhe konkretisht për zbatimin e kontratës në tenderin me objekt “Blerje mjeti vetëshkarkues i përdorur”, konstatohet se:

Me OE fitues për lotin II “C...” sh.p.k. është lidhur kontrata nr. 986/10, datë 7.11.2014 dhe me Urdhrin nr.986/11, datë 10.11.2014 të titullarit të institucionit është ngritur grupi për marrjen në dorëzim të mallit. Në aktin e marrjes në dorëzim të mjetit datë 13.11.2014, i cili përcakton gjendjen teknike të mjetit në momentin e marrjes në dorëzim, specifikimet teknike të mjetit marrë në dorëzim nuk përputhen tërësisht me ato të përcaktuara në DST, pasi nuk rezulton të ketë bashkangjitur skicimet, parametrat teknik etj. të mjetit, ku të jetë përcaktuar peshëmbajtja, distanca aksiale dhe gjatësia e karrocisë. Në të njëjtën kohë konstatohet se, Komisioni i marrjes në dorëzim ka mbajtur dhe procesverbalin datë 12.11.2014 të marrjes në dorëzim ku është shprehur se ky mjet ka ardhur në Parkun e Transportit konform kushteve të përcaktuara mes firmës fituese dhe Njësisë së Prokurimit duke vepruar në kundërshtim me VKM nr.1. datë 10.1.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” me ndryshime, kreu VIII, pika 2/b. (Trajtuar hollësisht në fq.37-38 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Për këtë është rekomanduar:

DSHQ në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të ketë parasysh në të ardhmen që në zbatimin e procedurave të prokurimit publik dhe konkretisht në rastet e marrjes në dorëzim të mallrave, të përshkruajë qartë cilësitë teknike të tyre nëse është konform specifikimeve teknike të kërkuara dhe jo të përshkruaj gjendjen teknike të mallit të marrë në dorëzim.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Nisur nga auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimit publik për vitin 2015(4 mujori I) konstatohet në procedurën e prokurimit me objekt “**Blerje detergjente dhe mallra në ndihmë të kuzhinës dhe pastrimit**”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar Operatorin Ekonomik “I.” sh.p.k me vlerë oferte 2,591,910 lekë pa TVSH që është dhe vlera më e ulët e paraqitur, me arsyetimin se nuk ka paraqitur katalogët për disa mallra. Ndërkohë për OE “A...” me vlerë oferte 2,800,000 lekë pa TVSH, ka kërkuar sqarime për produktet e ofruara nga ai. Siç shihet për këta operatorë nuk është mbajtur i njëjti qëndrim duke vepruar në kundërshtim me nenin 53/1 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006, me ndryshime dhe nenin 64/5, kreu VII i VKM nr. 914 datë 29.12.2014, sipas të cilit “*çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal*”. Skualifikimi i OE “I.” sh.p.k. me vlerë më të ulët oferte është bërë në kundërshtim me aktet ligjore të sipërcituara duke sjellë si pasojë efekt negativ financiar me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 208,090 lekë** (2,800,000 lekë oferta fituese-2,591,910 lekë oferta me çmimin më të ulët). (Trajtuar në faqen nr. 39-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandoj:

Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirren aktet administrative), me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën totale **208,090 lekë**, nga anëtarët e KVO të përbërë nga: **P. B** – Kryetar, **B.K**- Anëtar dhe **E. M**–Anetar, pasi me veprimet e tyre në kundërshtim me LPP dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kanë krijuar efekt negativ financiar me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 208,090 lekë**, nga sklasifikimi i ofertës së Operatorit Ekonomik “I..” sh.p.k. i cili kishte dhe ofertën ekonomike me vlerë më të ulët. Pas kryerjes së procedurave administrative të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat për shumën e sipërcituar.

Menjëherë

C.MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në pikën 1 të VKM nr. 34, datë 7.01.1999 “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe Trajtimin e Personaliteteve të Larta” i ndryshuar, i propozohet Kryeministrit, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Shkarkim nga detyra” për:

1.Zj. K. V, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në zbatim të VKM nr. 34, datë 7.1.1999 “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe Trajtimin e Personaliteteve të Larta” me ndryshime, pasi në ushtrim të funksioneve drejtuese konstatohet se:

-Nga Institucioni i Presidentit të Republikës me shkresat nr. 884, datë 27.4.2015 dhe nr. 884/2, datë 29.4.2015 në mbështetje të pikës 14 të VKM nr. 34, datë 7.1.1999 me ndryshime është kërkuar nga DSHQ, rezervimi i ambienteve të Vilës në Dhërmi, për pushime të Presidentit të Republikës dhe familjes së Tij, në periudhën 11-31 Korrik 2015 si dhe me shkresën nr. 884/4, datë 9.6.2015 kërkohet të vihet në dispozicion të Presidentit të Republikës dhe familjes së Tij për pushime, Vila nr. 1 në Vlorë për periudhën 11-31 Korrik 2015.

Nga auditimi i korrespondencës së sipërme mes dy institucioneve, konstatohet se punimet për rehabilitim apo rikonstruksion e Vilës në Dhërmi, nuk kishin filluar siç pretendohet në përgjigjen e shkresës së datës 02.6.2015 dhënë Institucionit të Presidentit të Republikës, si dhe nga auditimi i planifikimit të nevojave buxhetore për investime rezulton se disa nga investimet e planifikuara për tu realizuar në vitin 2014 nuk janë realizuar dhe nuk ngelen prioritet realizimi i tyre në vitin 2015. Të gjitha fondet e çelura për realizimin e këtyre investimeve janë rialokuar për të rikonstruktuar një objekt i cili nuk është miratuar në buxhetin e vitit 2015. Po ti referohemi hartimit të Projektbuxhetit të DSHQ-së për vitin 2015, konstatohet se, përgjigja e shkresës nr. 884, datë 27.4.2015 dhe asaj nr. 884/2, datë 29.4.2015 të Institucioni i Presidentit me shkresat respektive të DSHQ-së nr.171//1, datë 27.4.2015 dhe nr. 171/3, datë 02.6.2015, nuk janë në rakordancë në afat kohor për sa i takon problemit të rikonstruksionit të Vilës Dhërmi. Më konkretisht, kërkesa nga Institucioni i Presidentit të Republikës për rezervimin e Vilës Dhërmi është bërë me datën 27.4.2015 dhe po në këtë datë është kthyer përgjigje se po “*merren masa për rikonstruksionin e saj*”, në një kohë që në buxhetin e vitit 2015 dhe pse ishte kërkuar fondi për rikonstruksionin e këtij objekti, nuk ishte miratuar nga Ministria e Financave, sipas trajtimit të bërë në Raportin e auditimit, për pasojë nga kjo Drejtori që pas mbarimit të sezonit veror paraardhës (viti 2014) duhet të ishin marrë masat për rehabilitimin e ambienteve që ato të ishin gati, me fondet që kishin në dispozicion nëse nuk kishte fonde për rikonstruksion total. Nga ana tjetër, konstatohet se, përgjigja e DSHQ-së ndaj kërkesës së përsëritur të Institucionit të Presidentit, është bërë me datë 02.6.2015, nr. 171/3, sipas të cilës njoftojnë se “*kanë filluar punimet rehabilituese për rikthimin e këtij objekti në kushte të përshtatshme*”, një kohë që, me datë 9.6.2015, pra 7 ditë

më pas, është bërë miratimi për transferimin e shpenzimeve kapitale me shkresën nr. 8456/1, nga Ministria e Financave.

Fondi për këtë investim në periudhën kur është bërë kërkesa e institucionit të Presidentit nuk rezulton të jetë miratuar. Meqenëse në VKM nr. 34, datë 7.1.1999 me ndryshime, pika 14, përcaktohet në mënyrë eksplicite se *"Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe familjeve të tyre në kohën e pushimit, iu vihet në dispozicion nga një apartament në rezidencat që administrojnë Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare në qendrat e pushimit"*, në përmbushje të këtij detyrimi ligjor, nuk rezulton që nga ana e DSHQ-së as të jenë njoftuar personalitetet e larta shtetërore sipas hierarkisë të përcaktuar në këtë VKM, mbi fillimin e procedurave për rikonstruksionin e Vilës në Dhërmi. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr. 34, datë 7.1.1999 me ndryshime, pika 14 dhe 2/c, Rregulloren e Brendshme të DSHQ, neni 19/ 13 dhe VKM-në nr. 229 datë 23.4.2004 "Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kreu VI, pika 1.1, pasi nuk janë hartuar në kohë nevojat për ofrimin e shërbimeve të trajtimit dhe plotësimit të nevojave jetësore të personaliteteve të larta shtetërore.

Po kështu dhe mos plotësimi i kërkesës për pushime të Presidentit të Republikës për periudhën 11-31 Korrik 2015 në ambientet e Vilës nr. 1-Vlorë, është në kundërshtim me aktet e sipërme ligjore, pasi nuk i është dhënë përgjigje kërkesës së Institucionit të Presidentit të Republikës pikërisht për ambientet e kësaj Vile, duke e anashkaluar disponibilitetin e saj dhe duke mos respektuar njëkohësisht dhe hierarkinë e rängeve zyrtare të përcaktuar me aktet ligjore e nënligjore, por duke shprehur gatishmërinë për vënien në dispozicion të ambienteve në rezidenca të tjera qeveritare.

Në këtë kontekst, DSHQ duhet të kishte disponibël për personalitetet e larta shtetërore në sezonin e pushimeve, rezidencat qeveritare për plotësimin e nevojave dhe kërkesave të tyre, në përputhje të plotë me VKM-në nr.34, datë 7.1.1999 me ndryshime, pika 14, ***pasi në zbatim të pikës 2/c të kësaj VKM-je detyra kryesore e DSHQ është trajtimi dhe plotësimi i nevojave të personaliteteve të larta shtetërore sipas përcaktimeve në këtë vendim. Për veprimet e mësipërme mban përgjegjësi titullare e institucionit zj.K.V (Trajtuar hollësisht në fq.42-45 të Raportit Përfundimtar të auditimit).***

-Gjithashtu nga auditimi i procedurave të blerjeve me vlerë të vogël për vitin 2014, konstatohet se të gjitha furnizimet me mallra janë kryer me procedurën e ceremonialit duke mos i ndarë se cilat i shërbejnë ceremonialit zyrtar dhe cilat janë për të përballuar nevojat e përditshme në kundërshtim me përcaktimin e ceremonialit zyrtar në VKM nr. 229, datë 23.04.2004 "*Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, me kreu II, pika 1/b, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "*Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", me ndryshime, paragrafi i fundit ku shprehet "*Për veprimtari të përcaktuar në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, vlera e përlllogaritur e prokurimeve me vlerë të vogël për artikuj apo grup artikujsh brenda një viti kalendarik të jetë nën vlerën e kufirit të ulët monetar*" dhe pika 3 e VKM nr. 358, datë 24.4.2013 "*Për mënyrën e prokurimit të mallrave, punëve e të shërbimeve, në kuadër të veprimtarive të ceremonialit zyrtar*" ku përcaktohet se "*Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, në rastet e organizimit të veprimtarive të veçanta, sipas ceremonialit zyrtar dhe kur i kërkohet nga Drejtoria e Protokollit të Shtetit, përdor këtë procedurë prokurimi për blerjen e mallrave apo kryerjen e punëve ose shërbimeve.*"

- Në disa urdhra prokurimi është përcaktuar marka në kundërshtim me pikën 5, neni 23 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar "*Për prokurimin publik*", ku thuhet "*Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve*

kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.”

- Të gjithë urdhrat e prokurimit nuk kishin të përcaktuar fondin limit në kundërshtim me pika 1/ç, kreu V të VKM nr.1, më datë 10.01.2007 “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku thuhet “*Kur sigurohen fondet, dhe ka nevojë për punë, mallra dhe shërbime, atëherë titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, i cili përmban të paktën sa vijon: objektin e prokurimit, **fondin e përlogaritur** të vënë në dispozicion, llojin e procedurës së prokurimit dhe justifikimin për përdorimin e saj”*

-Në disa raste konstatohen mospërputhje midis datave të hyrjes së mallit dhe kryerjes së procedurës së prokurimit ç’ka tregon për fiktivitet të kryerjes së procedurave.

(Trajtuar hollësisht në fq.31-33 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Menjëherë

2-Mbështetur në nenin 37 e 140 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe në kontratën e punës, titullari i Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës” për:

z. O. P, me detyrë Drejtor i Njesisë së Organizimit, Shërbimit dhe Trajtimit në Rezidenca, pasi në ushtrim të funksioneve të tij konstatohet se:

Nga Institucioni i Presidentit të Republikës me shkresat nr. 884, datë 27.4.2015 dhe nr. 884/2, datë 29.4.2015 në mbështetje të pikës 14 të VKM nr. 34, datë 7.1.1999 me ndryshime është kërkuar nga DSHQ, rezervimi i ambienteve të Vilës në Dhërmi, për pushime të Presidentit të Republikës dhe familjes së Tij, në periudhën 11-31 Korrik 2015 si dhe me shkresën nr. 884/4, datë 9.6.2015 kërkohet të vihet në dispozicion të Presidentit të Republikës dhe familjes së Tij për pushime, Vila nr. 1 në Vlorë për periudhën 11-31 Korrik 2015.

Nga auditimi i korrespondencës së sipërme mes dy institucioneve, konstatohet se punimet për rehabilitim apo rikonstruksion e Vilës në Dhërmi, nuk kishin filluar siç pretendohet në përgjigjen e shkresës së datës 02.6.2015 dhënë Institucionit të Presidentit të Republikës, si dhe nga auditimi i planifikimit të nevojave buxhetore për investime rezulton se disa nga investimet e planifikuara për tu realizuar në vitin 2014 nuk janë realizuar dhe nuk ngelen prioritet realizimi i tyre në vitin 2015. Të gjitha fondet e çelura për realizimin e këtyre investimeve janë rialokuar për të rikonstruktuar një objekt i cili nuk është miratuar në buxhetin e vitit 2015. Po ti referohemi hartimit të Projektbuxhetit të DSHQ-së për vitin 2015, konstatohet se, përgjigja e shkresës nr. 884, datë 27.4.2015 dhe asaj nr. 884/2, datë 29.4.2015 të Institucioni i Presidentit me shkresat respektive të DSHQ-së nr.171//1, datë 27.4.2015 dhe nr. 171/3, datë 02.6.2015, nuk janë në rakordancë në afat kohor për sa i takon problemit të rikonstruksionit të Vilës Dhërmi. Më konkretisht, kërkesa nga Institucioni i Presidentit të Republikës për rezervimin e Vilës Dhërmi është bërë me datën 27.4.2015 dhe po në këtë datë është kthyer përgjigje se po “*merren masa për rikonstruksionin e saj*”, në një kohë që në buxhetin e vitit 2015 dhe pse ishte kërkuar fondi për rikonstruksionin e këtij objekti, nuk ishte miratuar nga Ministria e Financave, sipas trajtimit të bërë në Raportin e auditimit, për pasojë nga kjo Drejtori që pas mbarimit të sezonit veror paraardhës (viti 2014) duhet të ishin marrë masat për rehabilitimin e ambienteve që ato të ishin gati, me fondet që kishin në dispozicion nëse nuk kishte fonde për rikonstruksion total. Nga ana tjetër, konstatohet se, përgjigja e DSHQ-së ndaj kërkesës së përsëritur të Institucionit të Presidentit, është bërë me datë 02.6.2015, nr. 171/3, sipas të cilës njoftojnë se “*kanë filluar punimet rehabilituese për rikthimin e këtij objekti në kushte të përshtatshme*”, një kohë që, me datë 9.6.2015, pra 7 ditë

më pas, është bërë miratimi për transferimin e shpenzimeve kapitale me shkresën nr. 8456/1, nga Ministria e Financave.

Fondi për këtë investim në periudhën kur është bërë kërkesa e institucionit të Presidentit nuk rezulton të jetë miratuar. Meqenëse në VKM nr. 34, datë 7.1.1999 me ndryshime, pika 14, përcaktohet në mënyrë eksplicite se *”Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe familjeve të tyre në kohën e pushimit, iu vihet në dispozicion nga një apartament në rezidencat që administrojnë Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare në qendrat e pushimit”*, në përmbushje të këtij detyrimi ligjor, nuk rezulton që nga ana e DSHQ-së as të jenë njoftuar personalitetet e larta shtetërore sipas hierarkisë të përcaktuar në këtë VKM, mbi fillimin e procedurave për rikonstruksionin e Vilës në Dhërmi. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr. 34, datë 7.1.1999 me ndryshime, pika 14 dhe 2/c, Rregulloren e Brendshme të DSHQ, neni 19/ 13 dhe VKM-në nr. 229 datë 23.4.2004 “Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kreu VI, pika 1.1, pasi nuk janë hartuar në kohë nevojat për ofrimin e shërbimeve të trajtimit dhe plotësimit të nevojave jetësore të personaliteteve të larta shtetërore.

Po kështu dhe mos plotësimi i kërkesës për pushime të Presidentit të Republikës për periudhën 11-31 Korrik 2015 në ambientet e Vilës nr. 1-Vlorë, është në kundërshtim me aktet e sipërme ligjore, pasi nuk i është dhënë përgjigje kërkesës së Institucionit të Presidentit të Republikës pikërisht për ambientet e kësaj Vile, duke e anashkuar disponibilitetin e saj dhe duke mos respektuar njëkohësisht dhe hierarkinë e rängeve zyrtare të përcaktuar me aktet ligjore e nënligjore, por duke shprehur gatishmërinë për vënien në dispozicion të ambienteve në rezidenca të tjera qeveritare.

Në këtë kontekst, DSHQ duhet të kishte disponibël për personalitetet e larta shtetërore në sezonin e pushimeve, rezidencat qeveritare për plotësimin e nevojave dhe kërkesave të tyre, në përputhje të plotë me VKM-në nr.34, datë 7.1.1999 me ndryshime, pika 14, ***pasi në zbatim të pikës 2/c të kësaj VKM-je detyra kryesore e DSHQ është trajtimi dhe plotësimi i nevojave të personaliteteve të larta shtetërore sipas përcaktimeve në këtë vendim. Për sa sipër mban përgjegjësi z. O. P, me detyrë Drejtor i Njësisë së Organizimit, Shërbimit dhe Trajtimit në Rezidenca.***

II. Mbështetur në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 72/2, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 81, kreu XI, i rekomandojmë **Agjencisë së Prokurimit Publik** të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore për anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla të listuar poshtë:

- | | | |
|----|------|---------|
| 1. | D. V | Kryetar |
| 2. | A. T | Anëtar |
| 3. | L. M | Anëtar |
| 4. | E. L | Anëtar |
| 5. | I. D | Anëtare |

Pasi nga auditimi i procedurave të blerjeve me vlerë të vogël për vitin 2014, konstatohet se të gjitha furnizimet me mallra janë kryer me procedurën e ceremonialit duke mos i ndarë se cilat i shërbejnë ceremonialit zyrtar dhe cilat janë për të përballuar nevojat e përditshme në kundërshtim me përcaktimin e ceremonialit zyrtar në VKM nr. 229, datë 23.04.2004 “Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me kreu II, pika 1/b, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ndryshime, paragrafi i fundit ku shprehet ***“Për veprimtari të përcaktuar në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, vlera e përllogaritur e***

*prokurimeve me vlerë të vogël për artikuj apo grup artikujsh brenda një viti kalendarik të jetë nën vlerën e kufirit të ulët monetar” dhe pika 3 e VKM nr. 358, datë 24.4.2013 "Për mënyrën e prokurimit të mallrave, punëve e të shërbimeve, në kuadër të veprimtarive të ceremonialit zyrtar" ku përcaktohet se "Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, në rastet e **organizimit të veprimtarive të veçanta**, sipas ceremonialit zyrtar dhe kur i kërkohet nga Drejtoria e Protokollit të Shtetit, përdor këtë procedurë prokurimi për blerjen e mallrave apo kryerjen e punëve ose shërbimeve."*

- Në disa urdhra prokurimi është përcaktuar marka në kundërshtim me pikën 5, neni 23 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar "Për prokurimin publik", ku thuhet "Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime."

- Të gjithë urdhrat e prokurimit nuk kishin të përcaktuar fondin limit në kundërshtim me pika 1/ç, kreu V të VKM nr. 1, më datë 10.01.2007 "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku thuhet "Kur sigurohen fondet, dhe ka nevojë për punë, mallra dhe shërbime, atëherë titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, i cili përmban të paktën sa vijon: objektin e prokurimit, **fondin e përlllogaritur** të vënë në dispozicion, llojin e procedurës së prokurimit dhe justifikimin për përdorimin e saj"

-Në disa raste konstatohen mospërputhje midis datave të hyrjes së mallit dhe kryerjes së procedurës së prokurimit cka tregon për fiktivitet të kryerjes së procedurave.
(Trajtuar hollësisht në fq.31-33 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 72/2, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", neni 79/i, kreu XI, i rekomandojmë **Agjencisë së Prokurimit Publik** të fillojë procedurat për dhënien e "**gjobës**" në masën **50,000** lekë për anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave të listuar poshtë:

1. P. B	Kryetar
2.B.K	Anëtar
3.E. M	Anëtar

Pasi nga auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimit publik për vitin 2015(4 muhori I) konstatohet në procedurën e prokurimit me objekt "**Blerje detergjente dhe mallra në ndihmë të kuzhinës dhe pastrimit**", Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar Operatorin Ekonomik "I.." sh.p.k me vlerë oferte 2,591,910 lekë pa TVSH që është dhe vlera më e ulët e paraqitur, me arsyetimin se nuk ka paraqitur katalogët për disa mallra. Ndërkohë për OE "A.." me vlerë oferte 2,800,000 lekë pa TVSH, ka kërkuar sqarime për produktet e ofruara nga ai. Siç shihet për këta operatorë nuk është mbajtur i njëjti qëndrim duke vepruar në kundërshtim me nenin 53/1 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006, me ndryshime dhe nenin 64/5, kreu VII i VKM nr. 914 datë 29.12.2014, sipas të cilit "çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal". Skualifikimi i OE "I.." sh.p.k. me vlerë më të ulët oferte është bërë në kundërshtim me aktet ligjore të sipërcituara duke sjellë si pasojë efekt negativ financiar me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 208,090 lekë** (2,800,000 lekë oferta fituese-2,591,910 lekë oferta me çmimin më të ulët). (Trajtuar hollësisht në fq.39-42 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Miranda Haxhia përgjegjëse grupi dhe Ina Sokoli, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Zbatimit të Standardeve, Drejtori i Departamentit dhe Drejtori i Përgjithshëm.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT